



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria Kosovës / Vlada Kosovo / Government of Kosovo
Ministria e Financave dhe Transfereve/ Ministarstvo za Financije i Transfere
Ministry of Finance and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo

ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE

Njësa Org. Org. Jedin. Org. unit: Z-Q

Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No: 09.06.3284

Nr. Faqes Data Datum: 05.07.21
Broj stranica No paper: 20

01 DALËSE PRISHTINË/A

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT - BKS
KOSOVSKI URED OSIGURANJA - KUO
KOSOVO INSURANCE BUREAU - IBB

Nr. 770/21 Dc. 05-07-2021
PRISHTINË



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR SHKËMBIM TË DHËNAVE

NDËRMJET:

BYROSË KOSOVARE TË SIGURIMIT (BKS)

DHE

ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS (ATK)

KORRIK 2021

Kjo marrëveshje bashkëpunimi është përpiluar mbi bazën e konsultimeve, diskutimeve dhe angazhimeve konkrete të zhvilluara ndërmjet Byrosë Kosovare të Sigurimit dhe Administratës Tatimore të Kosovës me qëllim të shkëmbimit të të dhënave në kohë reale ndërmjet vete, për informata që lidhen me entitetet juridike që janë të regjistruara dhe vepronë në Republikën e Kosovës dhe është në funksion për ngritjen dhe lehtësimin e mëtutjeshëm të koordinimit dhe bashkëpunimit ndër-institucional.

Për sa i përket më sipër, palët bien dakord të respektojnë qëllimin e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit si më poshtë.

Neni 1

Palët

- 1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi (këtu e tutje: Marrëveshja) lidhet ndërmjet Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS) dhe Administratës Tatimore të Kosovës (ATK).**
- 2. Byroja Kosovare e Sigurimit (në vijim BKS), përgjegjëse për zbatim të Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia e përfaqësuar nga Z. Sami Mazreku - Drejtor Ekzekutiv i BKS-së,**
- 3. Administrata Tatimore e Kosovës (në vijim ATK) sipas Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L102 dhe Nr. 04/L-223 përgjegjëse për zbatimin e këtij Ligji, Ligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale, Ligjit për Tatimin në të Ardhurat nga Korporatat, Ligjit për Tatimin në Vlerën e Shtuar dhe çdo legjislacioni tjetër të zbatueshëm në Kosovë, e që i ngarkon detyrën të administrojë çdo lloji tatimi, e përfaqësuar nga Z. Ilir Murtezaj, Drejtor i Përgjithshëm i ATK-së.**

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit është shkëmbimi i të dhënave ne mes ATK-së dhe BKS-së në kohë reale për entitetet juridike në Republikën e Kosovës, dhe shkëmbimi të tillë i të dhënave mundëson përmirësimin e ciklit të regjistrimit të mjeteve motorike në Kosovë, si dhe shmangien e rasteve të mashtrimit dhe realizimin e procedurave të dëmshpërblimit të palëve të dëmtuara në kohën dhe në masën e duhur, për të cilat veprime dhe procedura BKS është bartëse zyrtare.

Neni 3

Fushëveprimi

- 1. Kjo Marrëveshje vendos natyrën dhe nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet BKS-së dhe ATK-së.**

2. Kjo Marrëveshje po ashtu vendos procedurat, kushtet dhe kriteret për lehtësimin e shkëmbimit të informacioneve me interes të ndërsjellë dhe përmes kanaleve të sigurta ndërmjet BKS-së dhe ATK-së.

3. Dispozitat e kësaj Marrëveshje, po ashtu edhe kërkesat tjera ligjore duhet respektuar nga të dy palët nënshkruese.

Neni 4

Zotimet dhe detyrimet ndërmjet palëve lidhur me konfidencialitetin

1. Të dy palët zotohen ta shqyrtojnë me kujdes çdo kërkesë formale që i bëjnë palës tjetër, që të sigurohen se kërkesa është e arsyetuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi.

2. Të gjitha të dhënat, informacionet dhe dokumentet zyrtare të cilat vihen në dispozicion nga palët nënshkruese do të përdoren vetëm për qëllime të aktiviteteve zyrtare dhe për çdo shpalesje të paautorizuar e cila mund të bien ndesh me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave, përgjegjësinë do ta mbajë secila palë.

3. Informatat e pranuar, sipas kësaj marrëveshje janë të natyrës së besueshme dhe do të përdoren vetëm për qëllimet e parapara në këtë Marrëveshje. Nuk mund të bëhet asnjë përdorim tjetër ose shpërndarje e informatave pa konsultim paraprak dhe autorizimin me shkrim të palës që i ofron informatat.

Neni 5

Përmbajtja e të dhënave që do të shkëmbehen

1. Të dhënat që do të këmbehen me këtë MOU, përfshijnë, por nuk janë të limituara, në të dhënat e entiteteve juridike si më poshtë:

- a) Numri i biznesit,
- b) Numri fiskal,
- c) Emri i biznesit,
- d) Emri tregtar,
- e) Lloji i biznesit,
- f) Rruga e adresës,
- g) Vendi i adresës,
- h) Komuna e adresës,
- i) Kod i postar i adresës,
- j) Telefoni,
- k) Përfaqësuesit ligjor,
- l) Numri i TVSH,
- m) Statusi TVSH,

- n) Lista e aktiviteteve e biznesit,
- o) Lista e njësive operuese,
- p) Data e themelimit,
- q) Email; etj.

Neni 6

Raportimi i të dhënave nga Byroja Kosovare e Sigurimit

1. BKS-ja përmes kësaj Marrëveshje obligohet që të gjitha detajet që lidhen me sigurimet e ndryshme sipas kategorizimit të tyre si dhe kompensimet e dëmeve për personat fizik dhe juridik t'i ndajë në mënyrë elektronike me Administratën Tatimore të Kosovës, bazuar në specifikacionet e kërkuar nga kjo e fundit.
2. BKS-ja, pajtohet që t'i ofrojë ATK-së qasje të pakufizuar në çdo kohë në të gjitha informatat relevante për çështje tatimore të cilat ajo i ka në zotërim.
3. BKS-ja duhet të ofrojë dhënat për provizionet teknike, provizionet e arkëtueshme, rezervat, të hyrat nga primet e sigurimeve, ri-sigurimeve, primeve të fituara, përfshirë numrin e veturave siguruara dhe atyre jo siguruara nga qytetaret dhe bizneset.
4. BKS-ja zotohet që të mbajë seminare dhe trajnime për zyrtarë të ATK-së rreth të hyrave, pagesave dhe shpenzimeve të TPL – sigurimeve vendore, policave sigurimit, fondit të kompensimit, etj.

Neni 7

Mënyra e shkëmbimit të informatave

Shkëmbimi i informacioneve sipas nenit 2 dhe 3 mes palëve nënshkruese të kësaj marrëveshje do të kryhet në kohë reale. Thirrja e të dhënave nga BKS bëhet përmes Numrit Unik Identifikues (NUI), përmes numrit të Biznesit NRB apo përmes Numrit Fiskal.

Neni 8

Qëllimi i përdorimit të dhënave

1. BKS-ja, përmes Qendrës Informative të Sigurimit do të mbledhë, përpunojë dhe publikon statistika të besueshme, do të standardizojë praktika të ndryshme me qëllim të shmangies së rasteve të mashtrimit dhe realizimin e procedurave të dëmshpërblimit të palës së dëmtuar në kohën dhe në masën e duhur.
2. Qendra Informative e BKS-së mbledhë dhe ruan të dhënat e sigurimit e detyrueshëm nga autopërgjegjësia në Republikën e Kosovës.
3. Qendra Informative mbledhë, përpunon dhe i ruan këto të dhëna dhe i vë në dispozicion personave të autorizuar, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara me Ligjin nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe aktet e tjera përcjellëse.

Neni 9
Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave

Të dhënat personale ruhen konform legjislacionit në fuqi vetëm për atë kohë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit për të cilin janë grumbulluar ose përpunuar më tutje. Pas këtij afati, të dhënat personale do të asgjësohen, fshihen, shkatërrohen, bllokohen ose bëhen anonime, përveç nëse është paraparë ndryshe me Ligjin për Lëndën Arkivore dhe Arkivat ose me ndonjë ligj tjetër përkatës.

Neni 10
Fillimi, zgjerimi dhe mbarimi i bashkëpunimit

1. Marrëveshja do të jetë në fuqi nga data e nënshkrimit deri në përfundim ose deri sa të zëvendësohet nga ndonjë marrëveshje ose instrument tjetër.
2. Marrëveshja mund të përfundohet nga secila palë duke njoftuar paraprakisht me shkrim 30 ditë më herët palën tjetër, ndërsa mund të plotësohet dhe ndryshohet vetëm pas marrëveshjes me shkrim nga të dyja palët.
3. Në rast të përfundimit procedurat, kushtet dhe kriteret lidhur me përdorimin dhe shpërndarjen e informatave të shkëmbyera sipas kësaj Marrëveshje vazhdojnë të jenë në fuqi dhe janë detyrues për palët sa i përket informatave të marra nga pala tjetër sipas kësaj Marrëveshje para përfundimit.
4. Palët pajtohen që çdo mosmarrëveshje apo keqkuptim ta zgjidhin me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjellë si dhe bazuar në ligjet në fuqi.
5. Kjo Marrëveshje do të nënshkruhet në katër (4) kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga dy (2) kopje për secilën palë.

Byroja Kosovare e Sigurimit

Sami Mazrekaj

Drejtor Ekzekutiv



Datë: 05/07/2021

Administrata Tatimore e Kosovës

Ilir Murtezaj

Drejtor i Përgjithshëm



Datë: 05/07/2021